

LIGJ
Nr. 33/2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9108, DATË 17.7.2003 “PËR SUBSTANCAT DHE PREPARATET KIMIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9108, datë 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 23 bëhen këto ndryshime:

1. Emërtimi “Inspektorati Shtetëror i Mjedisit” zëvendësohet me fjalët “Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit”.
2. Shkronja “d” ndryshohet si më poshtë:
“d) Merr masa urgjente në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.”.
3. Shkronja “e” shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 24 bëhen këto ndryshime:

1. Emërtimi “Inspektorati Sanitar Shtetëror” zëvendësohet me fjalët “Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit” dhe emërtimi “Inspektorati Shtetëror i Mjedisit” zëvendësohet me fjalët “Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit”.
2. Pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:
“dh) Merr masa urgjente në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 3

Pas nenit 24 shtohet neni 24/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 24/1
Klasifikimi i dënimeve

1. Në zbatim të neneve 23, 24 dhe 25 të këtij ligji dhe ligjit për inspektimin, inspektorët e inspektorateve përkatëse vendosin një nga dënimet kryesore si më poshtë:
 - a) gjoba;
 - b) urdhërimi për ndreqjen e parregullsive.
2. Krahës dënimit kryesor, inspektorët në zbatim të nenit 26 të këtij ligji, vendosin edhe një ose disa nga dënimet plotësuese si më poshtë:
 - a) mbylljen e veprimtarisë;
 - b) heqjen e licencës;
 - c) sekuestrimin e produkteve të rrezikshme.”.

Neni 4

Në nenin 26, pikat 8, 9, 10 dhe 11 shfuqizohen.

Neni 5

Pas nenit 26 shtohet neni 26/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 26/1

1. Gjopa dhe dënimet plotësuese vendosen në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin nga inspektorati, i cili fillon i pari procesin e inspektimit.

2. Kundër vendimit të inspektorit ose inspektorëve, mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.

3. Gjobat e vëna derdhen në Buxhetin e Shtetit dhe paguhen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit. Për çdo ditë vonesë, pas plotësimit të këtij afati, kundërvajtësi detyrohet të paguajë, përveç gjobës, një shumë të barabartë me 2 për qind të gjobës për një afat deri në 30 ditë. Me kalimin e këtij afati zbatohen dispozitat në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 6

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

Shpallur me dekretin nr. 7992, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani